

Ta ruajmë të pastër, të bukur dhe të blertë, Steblevën tonë

STEBLEVA



GAZETË E SHOQATËS "STEBLEVA"

Nr.9. Korrik-Gusht 2008. Çmimi 50 lekë.

Në këtë numër do të lexoni:

Zëri ynë i përparuar për çështjen e tokës dhe të pronave

Nga Mersin Hoxha
FAQE 2

STEBLEVA DHE VIZIONI I SAJ I HERSHËM PROPËRËNDIMOR

Nga Hajredin Kurti
FAQE 2

ASFALTOHEN KILOMETRAT E PARË TË RRUGËS Librazhd - Steblevë

FAQE 6

CEREMONIA E FLAMURIT KOMBËTAR NË DASMA

FAQE 3


LUFTA E STEBLEVËS E VITIT 1920

FAQE 5

ADEM BOJAXHIU NJERI I BESËS, I KUVENDIT DHE I PUSHKËS

FAQE 4

PRONA TË SHKOJË TEK I ZOTI



Në numrin e ardhshëm: Projekti "AMBO" kalon në Steblevë



FALENDERIM

Falenderojmë Kompaninë B & A- 02 sh.a. distributor i BP (British Petroleum) në Shqipëri për sponsorizimin e këtij numri të gazetës "Stebleva"




REDAKSIA E GAZETËS "STEBLEVA". Drejtor: Mersin Hoxha/ Redaktorë: Halil Kurti, Asjap Gruda, Vilma Disha, Artan Lila, Reshat Gruda. Kryeredaktor: Sakip Cami

Zëri ynë i përparuar për çështjen e tokës dhe të pronave



Nga Mersin Hoxha
Kryetar i Shoqatës

I gjithë opinioni publik, mediatic dhe deri diku edhe politik tashmë janë për abrogimin e ligjit 7501 për token, si ligj komunist dhe aspak demokratik. Ky ligj i dështuar ekonomik që çoi në mos shfrytëzimin e tokës dhe në shit-blerjen e saj pa kriter dhe pa çmim ka dëmtuar rëndë ekonominë, politikën dhe demokracinë shqiptare. E në këtë plan edhe Stebleva ka zërin e saj. Bile duhet theksuar se Stebleva ka patur prej ko-



hësh zërin e saj të përparuar për çështjen e tokës dhe të pronave në tërësi. Stebleva është i vetmi fshat që ka tapinë e saj origjinale që në vitin 1937, e depozituar në arkivin e Shtetit. Stebleva është i vetmi fshat që nuk ka zbatuar reformën agrare të vitit 1946 sepse seicili ka patur tokën e vet dhe nuk ka patur çfarë tu heqë dhe çfarë tu shtojë fshatarëve të saj, por me drejtësi ka ndarë tokat, kullo-

tat dhe pyjet.

Megjithëse ka shumë steblevas të larguar kjo nuk do të thotë dhe nuk ka arësye që tu merret toka atyre që nuk janë dhe tu jepet atyre që janë. Toka është blerë me flori nga të parët tanë dhe është mbrojtur me gjak, prandaj atë nuk e gëzon dhe trashëgon askush që nuk e meriton. Duke zgjidhur drejt çështjen e tokës ne njëkohësisht bëjmë një detyrë madhore

ndaj fshatarëve tanë, por njëkohësisht ndaj tërë kombit sepse vetëm duke shkuar toka tek i zoti ajo mund të shitet e të blihet, mund të zhvillohet tregu i tokës, mund të zhvillohet ekonomia e tregut në të cilën ka 18 vjet që jemi futur. Së shpejti projekti i gazsjellësit "AMBO" do të kalojë edhe në Steblevë, kështu duke zgjidhur problemin e tokës, ne zgjidhim edhe çështjen e investimeve në vendin tonë. Por ka elementë që na pengojnë. Ne i jemi drejtuar Ministrisë së Bujqësisë dhe Komisionit të Ndarjes së Tokave për këtë problem, Kryetarit të Qarkut të Elbasanit dhe të Dibrës, rrethëve të Librazhdit dhe të Bulqizës, por vemë re shumë burokraci dhe pengesa. Kalimi i Steblevës juridikisht në rrethin

e Librazhdit nuk e pengon gjë rrethin e Bulqizës apo Qarkun e Dibrës që të transferojë dokumentacionin e tokës sepse brenda një shteti jemi dhe shteti na përplas sa andej këndeje duke na thënë: "Kërkoni dhe gjejini vetë dokumentacionin". Zotërinj, ne e kemi dokumentacionin, dhe çështje më kryesore kemi tokën tonë, por ju mos u përpini të na hidhni hi syve. Para vitit 2005 ka patur përpjekje për ti përdorur tokat e Steblevës të tjerët për qëllimi përfitimi, por ne nuk i kemi lejuar dhe nuk do ti lejojmë. Kush është i interesuar me të vërtetë për ligjin dhe shtetin le të vijë në Steblevë se atje është edhe toka edhe dokumentacioni.

Toka duhet dhe do të shkojë medoemos tek i zoti.

PRONA ËSHTË E SHENJTË

(T'u japim fund zvarritjeve burokratike për kthimin e pronave)

Një problem tepër shqetësues dhe që akoma nuk ka gjetur zgjidhje për banorët e fshatit Steblevë mbetet problemi i kthimit të pronave. Disa familje që deri në vitin 1991 kanë qenë banorë të fshatit duke përfituar nga Ligji 7501 datë 19.07.1991 "Për tokën" kanë arritur të marrin certifikatën e pronësisë mbi tokën, sigurisht duke qenë në tokë të tyre. Ndërsa pjesa tjetër që përbën pjesën dërmuese nuk kanë mundur ta zgjidhin këtë problem.

Ndër vite sa herë që Kuvendi ka nxjerrë ligje të reja për pronat. Dosjet e pronave tona janë bërë e ribërë, aq herë sa është kërkuar nga Komisioni i Kthimit të të Pronave të Prefekturës së Elbasanit.

Që ky problem të gjejë zgjidhje përfundimtare, meqenëse edhe koha nuk premtion, duhet që Zyra e Kadastrës në Librazhd të lëshojë vërtetimin e pronës sepse fshati Steblevë dhe në vitin 1946 nuk është prekur nga Reforma Agrare komuniste.

Deri më tani vihet re një zvarritje e madhe burokratike por që nuk e dimë nëse është e qëllimshme apo thjesht burokratike. Pa tapitë kadastrale Komisioni i Kthimit të pronave nuk lëshon asnjë dokument pronësie. Pra çdo gjë është paralizuar.

Ndarjet e reja administrative, kalimi i Steblevës nga Dibra në Librazhd, ka qenë një arsye shtesë për mos realizimin e ndarjeve të tapive.

Ky problem sheqëaues tashmë po i kalon të 10 vjetët.

Shoqata "Stebleva" i ka dërguar disa shkresa edhe institucioneve shtetërore që merren me këtë problem dhe konkretisht ministrit Gjana, Kryetarit të Këshillit të Qarkut të Elbasanit Ardian Turku, Kryetarit të Këshillit të Qarkut Dibrë Naim Gazidede, Kryetarit të Komunës Steblevë, Xhavit Boriçi, Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit etj.

Ministria e Bujqësisë na kujton se duhet ti drejtohem Arkivit Qendror të Shtetit, Elbasani na thotë ti drejtohem Dibrës e kështu me rradhë.

Ne nuk kemi pse kërkojmë nga një zyrë në tjetrën. Ne jemi pronarë dhe kemi tapitë e vitit 1937.

Ju lutemi zgjidheni sa më parë këtë problem të mbartur ndër vite.

Nexhmije BAUSHI

STEBLEVA DHE VIZIONI I SAJ I HERSHËM PROPËRËNDIMOR



Nga Hajredin Kurti

Një komb, një krahinë, një fshat apo një fis e bëjnë të famshëm bijtë e tij. Si do të jenë bijtë e tyre ashtu do të jetë edhe e ardhmja e tyre. Shumë prej tyre prirën nga pozicionet gjeopolitike dhe interesat e çastit, por kur kemi të bëjmë me vizion, ky nuk kristalizohet në një ditë apo në një vit por me dekada dhe shekuj. Stebleva ka patur dhe ka një vision të hershëm propërëndimor. Bijtë e saj janë shkolluar në përrëndim dhe mësimet e Përrëndimit janë përpjekur ti bijnë në Shqipëri.

Një komb, një krahinë, një fshat apo një fis e bëjnë të famshëm bijtë e tij. Si do të jenë bijtë e tyre ashtu do të jetë edhe e ardhmja e tyre. Shumë prej tyre prirën nga pozicionet gjeopolitike dhe interesat e çastit,

por kur kemi të bëjmë me vizion, ky nuk kristalizohet në një ditë apo në një vit por me dekada dhe shekuj. Stebleva ka patur dhe ka një vision të hershëm propërëndimor. Bijtë e saj janë shkolluar në përrëndim dhe mësimet e Përrëndimit janë përpjekur ti bijnë në Shqipëri.

Jo rastësisht biri i Steblevës Islam Lama, pas studimeve të para në Stamboll kreu studimet e larta për jurispondencë në Francë dhe më pas u kthye në atdhe për të drejtuar lëvizjen patriotike. Po kështu edhe Zjnel Lama kreu studimet ushtarake në Itali. Ishte një prijëre e intelektualëve të hershëm të asaj kohe të Steblevës që tërhiqnin njëri tjetrin dhe shkolloheshin në Përrëndim, duke mos harruar kurrë vendin e tyre dhe duke u përpjekur që dijet e tyre ti vinin në shërbim të vendit tonë që ishte shumë i prapambetur në krahasim me këto vende.

Selaniku dhe Stambolli ishin stacionet e para të shkollimit në vitet 900 për të vazhduar më tej me Italinë, Francë etj. Prej Stebleve u shpërngul për në Selanik dhe më vonë për në Stamboll familja e Mustafa Qemalit (Conkaj), njeriut që më vonë do të bëhej Ataturk, babai dhe lideri i Turqisë moderne.

Nga Stebleva në Selanik dhe më vonë në Tiranë e SHBA do të shpërngulej familja e Vessel Kuçukut, profesorit të nderuar, biri i Steblevës. Për të vazhduar deri në ditët tona. Disa djem të Steblevës që në vitet 80 ju kundërvunë diktaturës komuniste, çanë kufijtë dhe u nisën drejt përrëndimit dhe SHBA. Të tillë qenë Agim Kurti, Besnik Kormaku, Lulzim Murati, Kadri Murati, Lulzim Kita etj. Agim Kurti u largua familjarisht në vitin 1988 dhe sot jeton në SHBA. Rexhep Kurti u dënua 13 vjet burg për shkak të tentativës së arratisjes së tij jashtë vendit. Të tjerë morën rrugët e përrëndimit pas fillimeve demokratike. Të shumtë janë djemtë dhe vajzat nga Stebleva që studiojnë në SHBA, Kanada, Angli, Gjermani, Itali etj. Ata kanë kryer universitete prestigjioze si ai i Oksfordit në Angli dhe sot punojnë në role shumë të rëndësishme në tregun financiar elektronik të Britanisë dhe SHBA. Bisnesmenë të suksesshëm nga Stebleva janë anëtarë të suksesshëm të Dhomës Britanike të Tregëtisë dhe të asaj Amerikane në Shqipëri. Janë njerëz me vision përrëndimor. Ata kanë luftuar dhe luftojnë për ta bërë Shqipërinë një stacion të bukur të Përrëndimit.

TRADITË, KULTURË, FOLKLOR

CEREMONIA E FLAMURIT KOMBËTAR NË DASMA

Në Steblevë si rrallë në ndonjë vend tjetër gjatë dasmave dhe gëzimeve zhvillohet një ceremoni e veçantë, ajo e marrjes së flamurit kombëtar, flamurit të ardhur nga Vlora në vitin 1912. Këtë flamur e kishte sjellë nga Vlora patrioti steblevas Hazis Lila. Në fillim këtë flamur e mbante familja e mësuesit veteran Islam Hoxha, më vonë ajo e Aqif Mysliut.

Për të realizuar ritin e marrjes së flamurit me orkestër e këngë patriotike, sipas zakonit, dy ditë përpara me bukë e kripë, lajmërohej flamurtari, i cili vendos krahqafë mbajtësen ku vendoset shtiza e flamurit, fillon i pari vallen që shoqërohet nga burra e gra që formojnë një ansambël të vërtetë. Nga ky moment solemn çdo veprim, çdo rit i dasmës, bëhet i shoqëruar nga orkestra me flamurin kombëtar në krye.

Dasmat në Steblevë kanë një karakter më epik dhe më burror. Një ditë përpara dasmës, aty nga ora dy e mbasditës mblidhen në shtëpinë e djalit, të afërmit, gra e burra dhe nisen për të marrë orkestrën, e cila përbëhet

Në Steblevë si rrallë në ndonjë vend tjetër gjatë dasmave dhe gëzimeve zhvillohet një ceremoni e veçantë, ajo e marrjes së flamurit kombëtar, flamurit të ardhur nga Vlora në vitin 1912. Këtë flamur e kishte sjellë nga Vlora patrioti steblevas Hazis Lila. Në fillim këtë flamur e mbante familja e mësuesit veteran Islam Hoxha, më vonë ajo e Aqif Mysliut

edhe të vdekurit. Një person ngarkohet vetëm për mbajtjen e flamurit kombëtar shqiptar.

Në mbrëmje mblidhen të mëdhenj e të vegjël, të ftuar e të paftuar, të veshur me rroba të fetës për të ndjekur ritin e "pjekjes së pogaçes" (bukës së grunjës me sheqer për të qënë e ëmbël miqësia).

Pogaçet gatohen nga hallat e dhëndërrit dhe kalojnë dorë më dorë nga gratë në valle për ti shkruar në me unazat e tyre.

Gjatë pjekjes rreth zjarrit vallja e përzier gra e burra nuk ka të mbaruar. Ajo vazhdon deri në orë e vona të natës, ku kërcimtarët shpalosin mjeshtërinë e tyre, ndërsa të rinjtë e pafejuar kapen në valle me vajzat e ëndrrave të tyre, rit që nënkupton vazhdimësinë e jetës, dashurisë e të dasmave.

Aty nga mesi, kur merr flakë vallja (ore-ore), digjet përparësia e sterrosur e vjerrës së nuses nën meloditë e këngëve humoristike që i këndohen asaj se "nuk ka qenë e zonja për këto punë dhe se tani do të vijë e zonja e tyre që do t'i bëjë më sërë e rradhë" duke aluduar për nusen. Një atmosferë gazmore, një mrekulli e vërtetë.

Me ritin e pjekjes së pogaçes, mbarojnë edhe aktivitetet e kësaj dite, për të vazhduar me ditën kulmore të marrjes së nuses. Në paraditen e kësaj dite vinë me rradhë të gjithë të ftuarit me dhurata ndër duar. Të parët sipas zakonit vijnë dajat e dhëndërrit. Dhuratat e tyre simbolike janë "deshët me brirë", në majat e të cilëve vendosen mollë të kuqe dhe kartëmonedha të reja. Ardhja e tyre është moment solemn.

Ata vijnë të gjithë siç janë në shtëpi. Në krye qëndron daja i madh, pastaj me rradhë të gjithë dajat e tjerë, djemtë e

dajave, vajzat, nuset e djemve të dajave dhe deri tek fëmijët që mbahen për duarsh nga nënat e tyre.

Për ti prituar ata, sipas zakonit, del përpara tyre i zoti i shtëpisë, babai i dhëndërrit, mixhallarët, vëllezërit e motrat e dhëndërrit dhe nuset e shtëpisë.

Dajat, mixhallarët dhe të gjithë të ftuarit e tyre, sipas zakonit priten me cyrle dhe daulle dhe me flamurin kombëtar, përpara se të arrijnë në oborrin e shtëpisë së dhëndërrit. Me të mbrurit në shtëpinë e dhëndërrit fillon vallja e përzier me burra e gra duke shpalosur një skenë të paparë folklorike me të gjitha ngjyrat e ylberit.

Mbasi mbaron pritja e të gjithë të ftuarve fillon riti i qethjes dhe rruajtjes së dhëndërrit. Daja ose kumbari (nuni) që i ka marrë flokët kur ka qenë i vogël, tani kryen ritin e rruajtjes së dhëndërrit. Flokët e prerë hidhen tek rrënjët e trandafililit, ndërsa vallja e përzier shoqëron me këngë këtë rit gjatë gjithë kohës.

Mbasi mbaron edhe ky rit, daullet marrin melodinë e përcjelljes së krushqve. Të gjithë të hypur në kuaj, në krye të tyre flamuri kombëtar me zhgabën e zezë dykrenare dhe pas tij krushku më i vjetër, kumbara, i cili ka marrë me vehte pogaçen për t'ja çuar fisit të nuses në shenjë të miqësisë së pastër dhe të ëmbël.

Nisja e krushqve shoqërohet jo vetëm me melodinë karakteristike të përcjelljes së tyre, të cilën e egzekutojnë me mjeshtëri ustallarët e ahengut, por edhe me krismat e armëve që zbazen në ato momente.

Gratë, të bashkuara këndojnë këngën karakteristike:



Çaste nga ceremonia e flamurit kombëtar në një dasmë

Treqind krushq po ju dërgojmë, treqind e një ju presim të vini".

Rrugës krushqit bëjnë garën e vrapimit me kuaj. Kalorësi që zë vendin e parë merr një dhuratë nga i zoti i dasmës.

Te nusja vargun e gjatë të dasmorëve e presin të afërmit dhe farefisit i saj. Në oborrin e shtëpisë deri sa ajo të bëhet gati e të përshëndetet me të afërmit vazhdojnë vallet me kërcimtarë nga të dyja palët. Mbasi i vendosin duvakun dhe e hypin mbi kalë vargu i dasmorëve nisët përpara i ndjekur nga nusja, të cilën e mbajnë për krahu vëllezërit, ndërsa kalin e tërheq për kapistre një djalë i vogël i fisit të saj. Mbas tyre vinë përcjellësit e nuses, të gjithë të afërm të saj, në krye të të cilëve është më i moshuari i cili bën dorëzimin e nuses tek më i moshuari i fisit të dhëndërrit.

Në një atmosferë të ndezur, mes melodive të cyrleve, kushtrimit të daulleve, krismat të armëve dhe këngëve të grave vazhdon riti i pritjes dhe i futjes së nuses në shtëpinë e dhëndërrit.

Në shtëpinë e djalit këngët dhe vallët s'kanë të pushuar.

Rrugët ndriçojnë, nuk ka kuresim për ndriçimin e rrugëve në dasma. Burra qëndrojnë veç e gratë veç nëpër konaqë, në verë qëndrojnë nëpër oborret dhe lëndinat e shtëpive të bëra gati për dasmë.

Hyzmetçinjtë shërbejnë kafe, cigare e karamelle.

Burrat kërcëjnë vallet e rënda dyshe, me një shkathtësi të paparë. Sa të rëndë në hedhjen e këmbëve, aq të lehtë në ngritje, aq elastic në trup, njëri më i qeshur se tjetri, njëri më i lehtë se tjetri, sikur luajnë, sikur fluturojnë si shqiponja, me krahët e mbështetur tek supet e njeri tjetrit, duke e vënë lehtë njërin këmbë në cep të daullës, shqiponja të vërteta, kreshnikë malesh. Dikush nxjerr nga qefji para kartmonedha dhe ja mbështet në ballë.

Nusja pritët me disa doke e zakone si me bukë të pjekur gruri (zakoni i mikpritjes bukë e kripë e zemër), me një shishe raki që e thyen nusja për të plasur syrin e keq, hidhet oriz mbi kokën e nuses, që të shtohet si orizi. Nusja lyen gishtat me mjaltë dhe prek parvazin e derës, që shtëpia të ketë lumturi dhe ëmbëlsi. Ajo futet në shtëpi me këmbën e djathtë, që të sjellë mbarësi.

Vallet vazhdojnë tërë natën. Një moment i veçantë është edhe momenti i futjes së dhëndërrit në dhomën e tij, ku dikush e godet me shaka me grushta, dikush e puth, pasi ky është çasti i ndarjes me shokët e tij, beqarë.

Këto zakone dhe rite transmetohen brez pas brezi.

Sulejman Agushi
(Sipas tregimit të të
jatit Bajram Agushi)



Veshje popullore e Steblevës

nga dy daulle dhe nga dy curly. Vargu i njerëzve shoqërohet nga këngët e grave e të vajzave të veshur me kostumet popullore karakteristike, me shami lepeku, të lëshuar mbrapa, kurse përpara e lidhur nga gusha, apo e kapur nga të dy anët e flokëve, që i kanë bërë rica rica, jeleku i kuq me gajtan të qëndisur përpara deri në fund të belit, boçja prej sermi, çorapet e kuqe, me lara deri tek gjuri e këpucët e zeza. Në qafë gjerdani me monedha argjendi e bronxi, ngandonjëhrë e dhe prej ari, që kur kërcëjnë tingujt e gjerdanëve krijojnë një melodi karakteristike.

Ustallarët e muzikës kalojnë përmes fshatit se këtu është lezeti që të shohin të gjithë. Muzikantët janë shumë pasionantë, nga daullet sikur tundet toka dhe nga curllet e violinat sikur ngjallen

Shtëpi karakteristike e Steblevës



ADEM BOJAXHIU

NJERI I BESËS, I KUVENDIT DHE I PUSHKËS

Kryeplak i Steblevës për 30 vjet me rradhë

Për Adem Bojaxhiun flasin shumë breza dibranësh, të vjetër e të rinj, nga Stebleva deri në Kalanë e Dodës.

Njeri me autoritet, qefali i fshatit për 30 vjet me rradhë.

Njeri i besës, i kuvendit dhe i pushkës. Edhe i jati Liman Bojaxhiu ka qenë qefali i fshatit para vitit 1912. Limani pati 5 djem dhe një vajzë, por 2 prej tyre, Nezirin dhe Selimin ja vranë serbët. Ademi ka lindur në vitin 1874 në një familje me tradita të mëdha patriotike të Steblevës.

Ai ka mbaruar Mejtepin turk në Steblevë dhe Medresenë në Stamboll. Zotëronte gjuhët turqisht dhe frëngjisht. Që nga viti 1912 e deri sa vdiq ka qenë kryeplak i Steblevës. Për mendjemprehtësinë dhe drejtësinë që e karakterizonte, ai thirrej për të ndarë gjyqe në gjithë Dibërën.

Në Sllovë ndodhi një hasmëri. Pranë një burimi ka ndodhur një nuse shtatzënë duke mbushur ujë. Sipër kalojnë ca dasmorë. Njëri prej tyre ka shti në ajër me pushkë. Nusja nga frika ka dështuar fëmijën.

Ka filluar ngatërresa dhe është ngjallur hasmëria. Për të ndarë sherrin thirret kryeplaku i Steblevës Adem Bojaxhiu. Së bashku me Ademin shkojnë edhe Qerim Shabani, Bilal Uliu e Ahmet Llapa.

Ademi pasi dëgjoi me kujdes ngjarjen kërkoi që në një vorbë të nxahet kos. Kosi të mos trazohet. Të nesërmen e vendos vorbën me kos tek burimi ku kishte ndodhur ngjarja dhe në prani të dy palëve qëllon me pushkë. Kosi në vorbë nuk trazohet.

-Dëgjoni o burra, thotë Ademi. Kosi nuk lëvizi nga krisma e armës. Fëmija në barkun e nanës është edhe ma i mbrojtur se kosi në vorbë. Gruaja ka dështuar se ka ardhë dekiku me dështue dhe jo prej krismës së armës.

Kështu u zgjidh ky konflikt jo i vogël nga plaku i urtë Adem Bojaxhiu kryeplaku i Steblevës dhe i krahahës së Gollobordës.

Pas 28 Nëntorit të vitit 1912 punoi për organizimin e pushtetit vendor dhe zbatimin e vendimeve të Qeverisë së Vlorës.

Ai menaxhoi me sukses kapërximin e zisë së bukës në vitin 1916, shpërnguljet dhe rikthimet e steblevasve në vitet 1912-1922 dhe veçanërisht drejtoi luftimet kundër serbëve në vitet 1913, 1915 dhe 1920. Në betejën e Qafë-Shkallës më 1915 kundër serbve Ademi ka



qenë organizator, zëvendësi dhe krahu i djathtë i Islam Lamës, patriot dhe strateg ushtarak. Edhe në Luftën e Steblevës më 1920 ka patur rol vendimtar si organizator në këtë luftë.

Ai për krahu lëvizjet për arsim në zonën e Gollobordës dhe në Steblevë.

Në vitin 1937, ndau kufijtë me fshatrat e tjerë, Klenjës, Gjinovecit, Trebishtit dhe Borovën dhe e regjistroi këtë tapi në kadastrën e qeverisë së Zogut, tapi e cila egziston edhe sot dhe që është e pakundërshtueshme.

Stebleva ka një teritor më të madh se fshatrat e tjerë dhe në kuptimin jo të keq të fjalës është lakmuar edhe nga fshatrat fqinj, të cilët e shfrytëzonin herë me leje dhe herë pa leje për dru zjarri dhe kullota.

Tregojnë se në kohën e Adem Bojaxhiut kryeplak të Steblevës, fshatrat e Klenjës, Gjinovecit e Trebishtit donin të merrnin pjesë të territorit të Steblevës, sepse nuk kishin kullota të mjaftueshme për bagëtitë, pyje për dru zjarri dhe ujë për vaditje e për mullinjte e bluarjes. Ligjërisht nuk kishin, por faktikisht ata shfrytëzonin resurset e Steblevës. Erdhi një

moment që kujtuan se u takonin atyre dhe për këtë ankuan në Prefekturën e Dibërës, për të aneksuar në favor të tyre.

U mbledhën kryepleqtë e të katër fshatrave në prani të komisionit të Pleqësisë së Dibërës, në vendin e quajtur Qeramova Padina, për të pleqëruar ankesën e këtyre fshatrave.

Adem Bojaxhiu, të cilit nuk i doli njeri përpara për mend e burrëri sa ishte gjallë i pyeti me rradhë kryepleqtë e Trebishtit, Gjinovecit dhe Klenjës: "Deri sot ku i keni marrë drutë e zjarrit? Po bagëtitë ku i keni kullotur? Po ujini ku e keni marë?"

-Në pyjet dhe bjeshkët e Steblevës që i kemi në prag të derës, ju përgjigjen ata.

-Shkoni na piqni një mish në hell, na sillni raki dhe hallvë të hamë e të pimë e të nderojmë këta miq që na kanë ardhë nga larg se drutë e zjarrit e ujin do ti merrni tek ne ku i keni marrë edhe deri më sot, por tokën nuk e merni në krahë se ajo është e zotit dhe e Steblevës, ka folur Adem Bojaxhiu.

Mbasi kanë ngrënë e kanë pirë në fund kryekomisioneri ka ndarë gjyqin duke thënë: "Mishi i Gjinovecit, rakia e Tre-

"Drutë e zjarrit dhe ujin do ti merrni tek ne, ku i keni marrë edhe deri më sot, por tokën nuk e merni në krahë se ajo është e zotit dhe e Steblevës", u ka thënë Adem Bojaxhiu kryepleqve të Klenjës, Trebishtit dhe Gjinovecit

bishtit, hallva e Klenjës, kurse tokat janë të Steblevës.

Steblevasit kanë patur fërkime edhe për caktimin e kufirit në malin e Letmit. U mbledhën kryepleqtë dhe pas disa kuvendimesh të gjata e mosmarrveshjesh, vendosën një zgjidhje të veçantë. Janë caktuar dy qingja të sapolindur, janë ushqyer dhe rritur nga e njëjta dele.

Njëri qingj i Steblevës dhe tjetri i Letmit. Pasi janë rritur janë lënë për t'u zënë. Ai qingj që do të mundej, do të tërhiqej nga mali. Është mundur qingji i Letmit. Ky kufi i atëhershëm është edhe sot.

Në Steblevë ka patur një foltore që egziston edhe sot. Kjo foltore i ngjante një miniparlamenti ku në krye qëndronte kryeplaku i fshatit. Karriket ishin përbërë prej guri të fortë, në mes qëndronte sofa e rrumbullakët edhe kjo prej guri. Këtu merreshin vendime të rëndësishme për punë dhe për luftë, për të ndihmuar familjet në nevojë etj.

Adem Bojaxhiu kishte lidhje të ngushta me patriotët e zonës si Dan Camin, Uke Dan Camin, Elez Koçin, Hysen Destanin si dhe me krerë të parisë së Dibërës si me Dine Hoxhën, Murat Kaloshin etj. Ademi kishte miqësi edhe me Aqif Pashë Elbasani (Bixhakçiu).

Pas djegjeve të fshatit nga serbët, Aqif Pashë Elbasani

për kontributin e mbrojtjes së tokave shqiptare dhe të Elbasanit (se pas Steblevës e kish rradhën Elbasani), Aqif Pasha u ofroi steblevasve toka dhe strehim. Një pjesë e steblevasve pas kalimit të periudhës së luftës u rikthyen prapë në Steblevë.

Së bashku me Dan Camin, pasi hanin drekën në Sepe-tovë shkollin në Dibër të Madhe apo atje ku kishin marrë porosi. Si mik i Danit kishte mbështetje dhe njohje edhe me Mbretin Zog. Kishte krijuar lidhje dhe aleanca me krerët e vendit, kështu që Stebleva na saj të njohjeve të tij ishte e paprekshme dhe e privilegjuar.

Adem Bojaxhiu kishte lidhje dhe shoqëri edhe me gjeneralin nga Mirdita Preng Pervizi.

Edhe gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare kontributi i Adem Bojaxhiut si njeri dhe si kryeplak ka qenë vendimtar. Së bashku me Hamit Abazin ka mobilizuar në rradhët e Br I dhe IV rreth 70 partizanë nga zona e Gollobordës. Në qershor të vitit 1944 ai zgjidhet i pari kryetar i Këshillit Nacional -Çlirimtar për Steblevën.

Vdiq në mars të vitit 1945. Ai nuk la fëmijë. Motra ime Yr-fie, u rrit në familjen e Adem Bojaxhiut dhe trashëgoi traditat e shokëqyera familjare e patriotike

Faik Kormaku

LUFTA E STEBLEVËS E VITIT 1920

Lufta e Steblevës e vitit 1920 është e të njëjtit dimension me luftën e Dibrës së vitit 1920 të drejtuar nga Elez Isufi dhe me shumë luftra të tjera të asaj kohe. Ajo nuk është luftë thjesht lokale por pjesë integrale e lëvizjes patriotike shiptare kundër serbve dhe kundër vendimeve të ndarjes së padrejtë të vitit 1913. Ajo është vazhdim i luftërave të vitit 1913 dhe 1915 kundër serbve dhe të vitit 1916 kundër bullgarëve.

Pozicioni gjeopolitik i Steblevës dhe fshatrave për rreth përballë qyteteve të Dibrës së Madhe dhe Strugës, një urë kalimi e drejt për drejtë për në Elbasan e Tiranë ka bërë që shumë kalime të armiqve dhe pushtuesve të bëheshin pikërisht në këtë vend.

Stebleva vepronte në bashkëpunim me fshatrat e tjerë fqinj Borovë, Zabzun, Llangë etj.

Kjo luftë është drejtuar nga komandantë të sprovuar e të përgatitur në shkolla ushtarake dhe nga prijës vendas trima të çartur.

Këto fshatra kishin një organizim të përsosur, një pleqësi të vendosur, një qeverisje vendore të shkëlqyer që dinte të përballonte çdo të papritur.

Lufta e Steblevës e vitit 1920 është e të njëjtit dimension me luftën e Dibrës së vitit 1920 të drejtuar nga Elez Isufi dhe me shumë luftra të tjera të asaj kohe. Ajo nuk është luftë thjesht lokale por pjesë integrale e lëvizjes patriotike shiptare kundër serbve dhe kundër vendimeve të ndarjes së padrejtë të vitit 1913. Ajo është vazhdim i luftërave të vitit 1913 dhe 1915 kundër serbve dhe të vitit 1916 kundër bullgarëve.

Pozicioni gjeopolitik i Steblevës dhe fshatrave për rreth përballë qyteteve të Dibrës së Madhe dhe Strugës, një urë kalimi e drejt për drejtë për në Elbasan e Tiranë ka bërë që shumë kalime të armiqve dhe pushtuesve të bëheshin pikërisht në këtë vend.

Stebleva vepronte në bashkëpunim me fshatrat e tjerë fqinj Borovë, Zabzun, Llangë etj.

Kjo luftë është drejtuar nga komandantë të sprovuar e të përgatitur në shkolla ushtarake dhe nga prijës vendas trima të çartur.

Këto fshatra kishin një organizim të përsosur, një pleqësi të vendosur, një qeverisje vendore të shkëlqyer që dinte të përballonte çdo të papritur.

Ata kishin organizuar sistemin e mbrojtjes territoriale të fshatrave sipas rregullave taktike e strategjike me pika vroj-

time në maja dominuese në kodra. Funkciononin gjashtë pika vrojtimi nga kufiri deri në Fushë Studën. Në çdo pikë vrojtimi vigjilonin 20-25 burra të armatosur me armatim të marra ushtrive italiane, serbe, bullgare etj.

Për rreth Steblevës ishin ngritur 6 pika vrojtimi në vendet strategjike.

Në anën veriore e verilindore të fshatit, ku rreziku dhe përqëndrimi i trupave të armikut ishte më i madh u ngritën tre pika vrojtimi tek Mashna e Rajkut dhe Stani i Balës (afër Postës së sotme të kufirit), në jug të fshatit në vendin e quajtur Murin dhe në jugpërqëndim në kodrën e Killavecit (vendi quhet lisi i Markut).

Pikat më të rëndësishme ku ishte përqëndrusur pjesa më

Adem Bojaxhiu, Qerim Bojaxhiu, Ramiz Agushi, Nazif Lila, Can Agushi, Elmaz Gruja. Këtu u plagos Murat Caushi.

Në Kojashume luftuan:

Jakup Agushi, Pajazit Agushi, Vahit Kormaku, Zenel Lila, Abedin Kuburi, Xhel Mrati, Sadik Murati, Zyber Murati, Ajdin Murati, Ramiz Agushi, Xhel Kuçuku etj

Në Murin kanë luftuar:

Ahmet Gaxha, Ismail Muli, Sali Uliu, Rexhep Tamizi, Ibrahim Abazi, Ymer Gjini, Xhafer Bale, Arif Bale, Ali Bale, Kapllan Kurti, Ramo Kurti, Hasan Kurti, Rexhep Bande etj.

Në Pishteic kanë luftuar:

Jakup Zhugli, Bajram Baba, Budin Budini nga Klenja, Sefer Maliqi nga Trebishti me gjithë çetën e tij si dhe Hasan Bande,

gjetën mercenarë vendas. Populli patriot i këtyre fshatrave nuk pranoi të ju jepte rekrutë për të vrarë vëllezërit e tyre. Sefer Maliqi organizoi çetën e tij në Trebisht. Grabitjet serbe e revoltuan së tepërmi popullatën e uritur. Serbët i futën njerëzit e thjeshtë të hapnin rrugë e instikamë pa pagesë. Steblevën e rrethuan me llogore e instikame nga anët e lindjes, verilindjes dhe juglindjes. Vetëm ana përqëndimore e Steblevës, ana e Borovës, Zabzunit dhe Llangës ishte e lirë.

Përqëndrimet më të mëdha serbe ishin në veri të Steblevës në rrugën Klenjë-Steblevë ku ngritëm edhe një postë ushtarake në vendin e quajtur Tornino Bordo dhe në lindje në Llakavicë ngritëm një tjetër. Vija e fron-

të forcave kryengritëse dhe të mirëorganizuar të Steblevës. Filloi luftë e ashpër midis çetnikëve serbë dhe luftëtarëve të Steblevës dhe të fshatrave të ardhura në ndihmë. Lufta zhvillohet e rreptë dhe në të katër anët. Luftëtarët e vendosur tek Mashna e Rrahkut, në malin e Pishteicës, në kodrën e Kojashumës dhe në Belishnicë, të organizuar dhe të fortifikuar organizuan rezistencë të pashembullt dhe i organizuan armikut humbje të shumta.

Nga Killaveci dhe nga Murini dëgjoheshin thirrjet e trimave që u jepnin zemër shokëve në frontet e tjera, ku lufta zhvillohet më e rreptë.

"Gajret burra, armikut bini se edhe Borova e Zabzuni ja mbrini" dëgjoheshin thirrjet e luftëtarëve. Zabzunasit dhe borovasit i dolën në shpinë armikut dhe ndihmuan forcat e Killavecit dhe të Murinit. Grupi I burrave nga Borova, së bashku me trimat e Steblevës të përqëndruar në kodrën e Killavecit lëvizën në krahun e majtë nga ana e Rrahiqes dhe duke u ngjitur bregut përpjetë tek varrezat në hyrje të fshatit në Belishnicë i sulmojnë mbas shpine forcat serbe që kishin ardhur nga drejtimi i Klenjës. Ndërsa grupi i luftëtarëve të Murinit i përforcuar me burra të armatosur nga Zabzuni lëvizën nëpër pyllin e Golemavenit për tu dalë serbve nga mbrapa tek stani i Balës, për të shpëtuar



e madhe e luftëtarëve të armatosur ishin ajo në Belishnicë, në malin e Pishteicës që mbronin fshatin nga mësymjet serbe, që vinin nga rruga e Klenjës në veri dhe ajo tek Mashna e Rajkut dhe stani të Balit që mbronin fshatin nga mësymjet serbe nga Llakavica në lindje. Fshatrat Borovë, Zabzun e Llangë do të ndihmonin me njerëz të armatosur, armatim dhe municion Steblevën që ishte vija e parë e frontit. Gratë do të mërreshin me gatimin dhe furnizimin me bukë, ushqime dhe municione deri në llogoret e luftës.

Luftëtarët që luftonin tek Mashna e Rakut dhe tek Stani i Balës ishin:

Tafil Bande, Iljas Elezi, Sali Gjini, Ibrahim Abazi, Murat Llapa që u plagos gjatë luftimeve, Sali Uliu, Demir Tamizi, Ibrahim Gaxha, Ahmet Gaxha, Islam Gjini, Spase Rajku, Bajram Nura, Liman Nura, Ismail Nura, Elez Hoxha, Ismail Hoxha, Hasan Hoxha, Adem Hoxha, Avdi Avda etj.

Në Belishnicë kanë luftuar: Zenel Kormaku, Rexhep Kormaku, Halil Murati, Emin Murati, Arif Lila, Ahmet Lila,

Sekulla Çota, Vangjel Steva, Selman Kormaku, Ismail Kormaku, Arif Caushi dhe bij të tjerë Steblevas.

Në Killavec kanë luftuar:

Emrulla Feta, Jonuz Disha, Destan Disha, Xhaferr Disha, Qerim Shabani, Sali Bajra, Bilal Bajra, Zenel Disha, Latif Disha, Stojan Cfarku, Ismail Muli dhe Hajdar Balla nga Borova që u plagos gjatë luftimeve.

Raporti i forcave:

Nga zona e Steblevës ishin 160 luftëtarë të armatosur.

Përballë qëndronin 400 e më shumë forca serbe dhe mercenarëve të komanduar nga Xhemal Kosturi dhe Daut Hodo. Theksojmë se mercenarët nuk ishin nga Stebleva dhe fshatrat për rreth por rekrutë të rekrutur dhe paguar nga zona të tjera. Stebleva dhe fshatrat e Gollobordës nuk pranuan të rekrutoshin as me para dhe as me forcë nga serbët dhe veglat e tyre Xhem Kosturi dhe Daut Hodo.

Serbët kishin pushtuar gjithë krahinën dhe fshtarat për rreth, Klenjën, Gjinavecin, Trebishtin etj dhe kërkonin të pushtonin Steblevën, Borovën, Zabzunin dhe Llangën, por nuk

tit ndiqte këtë trajektore: Fusha e Llakavicës, Kratat e Rames, Mali Pishteic, Tornono Bordo, Kratsta e Borovës, Zalli i Sebishtit.

Në këtë gjendje rrethimi Stebleva jetoi për 20 muaj nga janari 1919 kur forcat serbe u futën në Gollobordë deri më 7 korrik 1920 kur ato u shpartalluan në Luftën e Steblevës.

Me tërheqjen e forcave italiane në qershor 1920, serbët ishin pushtuesit e vetëm që nuk po tërhiqeshin nga Shqipëria dhe Dibra. Ata kërkonin jo vetëm të mos tërhiqeshin, por të sundonin pa rezistencë.

Beteja e 7 korrikut 1920

Duke u gdhirë 7 gushti 1920 forcat serbe dhe mercenare të drejtuara nga kapiten Xhem Kosturi rrethuan Steblevën duke kënduar këngë provokuese:

"O mos nuse moj syzezë Nesër të çohesh herët në mëngjes

Të bësh gati kalin dori Se do të nisesh për në Serbi..."

Pa mbaruar mirë kënga serbët u gjetën përballë zjarrit

edhe shokët tek Mashna e Rajkut. Lufta zgjati rreth 48 orë. Forcat çetnike serbe të ndodhura midis dy zjarreve detyrohen të ngrenë flamurin e bardhë e të dorëzohen duke pësuar shumë të vrarë, të plagosur dhe dëme materiale. Ndërsa kapiteni i tyre Xhem Kosturi dhe zëvendësi i tij Daut Hoda ja mbathën brenda matanë kufirit të 1913.

Fshatrat e Gollobordës u shprasin nga forcat serbe të cilët kishin 20 muaj që qëndronin në krahinë.

Nga luftëtarët e Steblevës dhe të fshatrave të Zabzunit, Borovës etj pati vetëm të plagosur të cilët i kemi përmendur sipas pozicionit luftarak ku kanë luftuar.

Nga forcat serbe pati edhe 22 robër të cilët i përcollën për në Tiranë. Robërit në fillim u grumbulluan tek hauri i Sali Bajres dhe ruheshin nga Saliu, Ismail Musliu, Sali Gjini dhe Liman Lila.

Jehona e luftës së Steblevës

Jehona e luftës së Ste-

(Vijon në faqen 6)

(Vijon nga faqja 5)

blevës u përhap në të gjithë vendin. Gazeta "Populli" e Shkodrës datë 14 gusht 1920 Nr 73 shkruan: "Sipas lajmeve kah Elbasani serbët kah Golloborda mësyen me ushtri të rregullt, por u thyen keqas. Sulmi mbi Steblevë zgjati një ditë dhe një natë."

Në këtë luftë spikati heroizmi masiv i luftëtarëve dhe luftëtareve të Steblevës si Adem Bojaxhiu, Vaid Kormaku, Ahmet Gaxha, Elez Hoxha, Zenel Kormaku, Rexhep Kormaku, Zenel Lila, Tafil Bande, Elmaz Gruja, Murat Llapa, Sali Gjini, Jonuz Disha, Destan Disha, Avdi Avda, Murat Caushi, Sali Uliu, Imer Gjini, Sadik Murati, Eëmrulla Feta si dhe grave trimëresha, Neslie Kormaku, Hatixhe Kormaku, Zylke Murati, Sulltane Hoxha, Fatime Hoxha, Gjyle Hoxha, Mejte Disha etj që gatu-

anin ushqim dhe transportonin municion për luftëtarët.

Populli e ka mishëruar këtë luftë në këngë:**KËNGA E LUFTËS SË STEBLEVËS**

1. Ditën e hënë sahati tetë Bani emën komandanti Komandant Xhemal Kosturi: Daut Doda ku të kam?! Mblidhi shokët me të ndigju Nji ferman me u këndu Krajli i serbit na e ka çu Në Steblevë për me shku.
2. Du me shku me e rrethu Kamb të gjallë mos me m'shpëtu Disa djem gjallë du me i zanë Se du me i çu në Beligrad Disa djem t'mi bini mu Sa ti shoh njiher me sy Çfar djemsh shqiponja ka ushqy

3. Kur merr vesh Stebleva e shkretë Lidhi besën për me vdekë Për me vdek, me lëftu Gjersa t'gjith me u faru Janë çu fëmija për t' lëftu Vetën e tyre me e nderu Gjithë grania spatat ka marrë "Për nderin tonë do të bëjmë varre" Disa trima fidai Bajnë yxhym n'istikam me hy
4. Plasi pushka gjimoi toka Kur duel Stebleva n'ato gropa Kujtoi seërbi se erdh Europa Plasi pushka gjimuen malet Kur duel Stebleva n'ato male Kujtoi serbi se janë shtatë krajet.
5. Plasi pushka në Murin Gajret shokë, Borova mbrin Vijnë Borovasi me ndihmu Si petrita tuj luftu



Plasi pushka te stani i Bales Porsi lufta e Çana- Kales Plasi pushka flakë me flakë Shokët e Xhemës u bënë me gjak Plasi pushka në Pishteic Ushtari i serbit kris e ik.

Xhemal Kosturim or i marru Ku i le shokët n'at përru?! Disa vra, disa zanë gjallë Janë surdisur për Tiranë.

Marrë nga libri Stebleva, Histori dhe Figura të Ramazan Hoxhës

Fakte historike**SHOQËRIA E BABAIT TË QEMAL STAFËS ME MUSTAFA QEMALIN (ATATURKUN)**

Garip Disha nga Stebleva tregon edhe për lidhjen e babait të Qemal Stafës (Hero i Popullit) me Mustafa Qemalin (Ataturkun).

Siç dihet babai i Qemal Stafës ka qenë nga fshati Zabzun i Dibrës. Edhe sot egziston fisi Stafa në Zabzun. Më vonë familja e gjyshit të Qemalit shpërngulet nga Zabzuni për në Elbasan. Babai i Qemalit pas përfundimeve të studimeve emërohet në kohën e Zogut nëpunës në Shkodër ku lind edhe Qemali. Mustafa Qemali ishte me origjinë nga Stebleva e Dibrës. Edhe sot egziston ara e Conkajve, pronë e gjyshit të Mustafait dhe trullit i Fasli Kuburit, nipi i Mustafait.

I jati i Qemal Stafës dhe Mustafa Qemali kanë mbaruar shkollën e lartë ushtarake në Stamboll. Në shenjë të miqësisë së tyre i jati i Qemal Stafës ja vuri emrin djalit të tij Qemal sikurse shoku i tij Mustafa Qemali. Qemal në turqisht do të thotë i shkëlqyer dhe babai i Qemalit dëshironte që djali i ardhshëm i tij të bëhej i shkëlqyer, Qemal.

ASFALTOHEN KILOMETRAT E PARË TË RRUGËS Librazhd - Steblevë

(Qeveria miraton 6 miliard lekë për asfaltimin e lotit të parë të kësaj rruge)

Prononcim i Zv.Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve z. Skënder Çota

Loti i parë është sistemim asfaltimi i pjesës Librazhd-Qafë-Studen. Punimet kryhen nga Firma"SH.A.Ruga Ura Asfaltim Nr 2 Elbasan, Murati shpk. Fillimi 7.11.2007 dhe mbarimi 6.12.2008. Mbikqyrës punimesh është firma S.P.I.T Tiranë. Një rrugë e gjërë e standarteve ndërkom-bëtare.

Qeveria, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e rrugëve e ka futur këtë rrugë në prioritetet e saj. Ajo ka miratuar 6 miliard lekë për lotin e parë të kësaj rruge.

Kjo rrugë e rëndësishme nuk do të jetë më një rrugë e ngushtë dhe e paasfaltuar, por një rrugë e rindërtuar nga e para dhe e asfaltuar sipas standarteve.

Vonesat për fillimin e asfaltimit të kësaj rruge të rëndësishme ishin pikërisht për hartimin dhe miratimin e një projekti bashkëkohor. Ishte menduar për një rrugë me gjërësi 4 metra që nuk do të plotësonte as standartet ndërkom-bëtare të rrugëve as nevojat gjithnjë në rritje të këtyre banorëve. Kështu u përgatit një projekt për një rrugë me gjërësi prej 6,5 metra dhe me vepra arti të plota. Ky projekt i përgatitur nga inxhinjerë me përvojë tashmë është miratuar.

Fondet janë alokuar qysh këtë vit. Punimet kanë filluar.

Është bërë tenderi i segmentit të parë që fillon në Librazhd. Deri tani kanë përfunduar dy kilometrat e para ndërsa brenda vitit 2009 pritet të përfundojë e gjithë rruga nga Librazhdi deri në Shupenzë (Ura e Çerenecit) ku bashkohet me rrugën e Tiranës dhe me Rrugën e Arbërit. Jemi në proces të tenderimeve dhe të akordimit të fondeve për të gjithë rrugën.

Rruga do të kalojë sigurisht në trasenë e vjetër, por do të zgjerohet, do të përmirësohet dhe do të shtrihet me asfalt. Ajo do të kalojë nga Librazhdi në Rrapun, Zgoshd, Lunik, Fushë-Studën-Steblevë-Klenjë-Ostren-Shupenzë. Gjatë kalimit nëpër zonat e banuara, qofshin këto fshatra, rruga do të pajiset me trotuare, tabela, ndriçim, vizime etj.

TRADITA SPORTIVE**TË RIPËRTËRIJMË SPORTIN E BUKUR TË SKIVE**

(Dikur ekip kampion, tashmë një sport i harruar)

Nga Defrim METHASANI

Mjafton ti hedhësh një sy gazetave të viteve 80 dhe kronikave televizive të kësaj kohe dhe do të bindesh se kemi të bëjmë me një traditë të bukur sportive të krijuar në vite. Shkollat e mesme të Klenjës dhe Steblevës përbënin bërthamën e ekipit të Korabit në sportin e skive dhe së bashku me Shishtavecin e Kukësit përbënin ekipin kombëtar të skive.

Ndonëse jemi në verë dhe dimri ndokujt i duket larg, le të shërbejë kjo si kujtesë për organizatorët e sportit, pushtetarët dhe biznesmenët, se në Steblevë shkohet edhe në dimër, bile Stebleva është qendra e sportit të skive në Shqipëri.

Fusha e Steblevës dhe e



Klenjës, dëborë e madhe dhe e zgjatur në kohë janë baza materiale natyrore që nuk e gjen në vend tjetër dhe që do ta dëshironte çdo vend.

Federata e sportit të skive duhet të mendojë që tani për bazën materiale dhe sponsori-

zimet e duhura që duke filluar që në dimrin e ardhshëm të organizojmë kampionatin zonal dhe kombëtar të skive.

Sportistët e vjetër dhe të rinj të Steblevës janë të gatshëm të japin ndihmesën e tyre në këtë drejtim.

Tregime brenda odës dibrane*

GJUHA E KAFSHËVE

Një çoban i vuri flakën një pureni ferrash. Aty kishte qenë një gjarpën. Gjarpni përpiqej të shpëtonte nga zjarri, por nuk arrinte të largohej sepse gjithë pureni ishte i përfshi nga flakët rrethore.

Çobanit i erdhi keq për gjarpnin. Gjarpën, gjarpën, por edhe ai shpirt ka, mendoi çobani. Zgjati shkopin dhe gjarpni u kacavir e u hodh në tokën e butë. Pastaj gjarpni u ngrit në bel dhe i tha çobanit: "O njeri i mirë, ti më shpëtove jetën, çfarë kërkon prej meje?"

E çfarë të kërkoj prej teje or gjarpër, unë nuk të shpëtova për të fituar prej teje. Sidoqoftë, thotë gjarpni, unë do të bëj një nder. Do të të mësoj gjuhën e kafshëve, por me një kusht. Këtë sekret të mos ja tregosh askujt.

Njeriu i mirë e mësoi shpejt gjuhën e kafshëve dhe kjo ju bë mania. Sa herë shikonte një kafshë duke vuajtur, qen, mace, lopë, viç, pulë, apo çfarëdo ndërhynte dhe i ndihmonte. Shpejt u bë mik i kafshëve. Një ditë bashkë me gruan shkoi tek njerziti e saj. Qëlloi që u zunë qentë dhe kjo aënkë ishte kaq e ashpër sa mund të shkaktonte viktima.

Njeiut të mirë nuk mund të rinte

EXHELI

Një burrë rreth të dyzetave, i pashpresë dhe i mërziur niset kuturu për me vdekë. Ma mirë me vdekë se me jetue pa pasuri e katandi, pa miqësi e shoqëri. Rrugës takoi një njeri që nuk ishte njeri. Ky kishte qenë exheli (vdekja).

-Çfarë ke që je i mërziur o njeri i mirë? e pyeti exheli.

-Du me vdekë, se për mu nuk ka kuptim ma jeta, pa pasuni, pa katandi, nuk më respekton dhe don njeri.

-Ti nuk ke me vdekë, rradhën me vdekë e kanë ata që kanë ba poshtërsi e që ta kanë nxi jetën ty, o njeri i mirë. Do të të jap një shishe me ujë të bekuar, me ilaç përëndie me shërue njerziti e sëmurë. Nëqoftëse më sheh mue në fund të kambëve, do me thanë se shërohet dhe jepi me pi një pikë lang nga shishja, nëqoftëse më sheh ke koka e të sëmurit do të thotë se kam ardhë me e marrë dhe se nuk shërohet, prandaj as mos i premtu as mos i jep ujë të bekuar. Njerzite të sëmurë mos u kërkoni pare, por lenë në dorë të atyne sa të duan me të dhanë. E kështu vazhdoi njeriu i mirë për dyzet vjet. U ba njeri i famshëm, bamirës me famë, fitoi edhe lekë edhe nam. Pas dyzetë vjetësh, në moshën tetëdhjetë vjeçare exheli erdhi për ta marrë.



Zoti kur e krijoi gjithësinë i llogariti të gjitha. Tani e ka rradhën për të ba llogarinë njeriu. Le të shohim si kullot bagëtia në një lëndinë. Në lëndinë me bar hanë delet. Zgjedhin ato fije bari me të cilat ushqehen vetëm ato e askush tjetër, vetëm ato i njohin dhe i pëlqejnë dhe i hanë. Në këtë lëndinë hanë edhe lopët. Edhe ato hanë ato fije që u bëjnë mirë, me të cilat bëjnë qumësht dhe prapë ka bar edhe për të tjerë. Në lëndinë hanë kuajt. Me buzët e tyre presin barin deri në rrëzë, por jo çdo lloj bari.

Ndryshe ndodh me dhitë. Ato presin majat e degëve, majat e luleve, majat e barit. Edhe gomerët s'e kanë mendjen tek bari i blertë, por tek barërat e trasha dhe tek porenit i ferrave ku hanë ferra. Pra në një lëndinë hanë kuajt, lopët, delet, dhitë, gomerët etj. Pra ka vend për të gjithë, ka ushqim për të gjithë.

Shembulli se si merren vesh kafshët asht një mësim për njerziti.

* Mbledhur e përshtatur nga Sakip Cami dhe treguar nga Ali Fejza



sehirxhi dhe me vrap shkoi dhe i ndau. Gruaja u çudit nga kjo aftësi e burrit të saj. Burri i ndodhur ngushtë mendoi që tja tregonte gruas këtë sekret pasi ajo do të bëhej xhelozë dhe do ti shkaktonte probleme.

E para që ja lexoi mendimin ishte macja. O bo bo ulëriti ajo, njeriu ynë më i dashur do të vdesë sepse ai do ti tregojë të shoqes sekretin e patregueshëm.

E dëgjoi qeni dhe filloi të lehë me tërbim: Mos trego, mos trego o njeri, o shpëtimtari ynë.

Njeriu dëgjonte dhe nuk bëzante. E shoqja i bënte presion: Ti fsheh diçka dhe nuk don të ma tregosh.

Gjeli i shëpisë hypi në një pemë dhe filloi të këndoje një këngë gazmore. Macja i thotë: "Or maskara, pse këndon ti, a nuk e sheh se zoti ynë mund të vdesë. Gjeli ju përgjigj: "Do të këndoje e nuk do të ndalem. Se asht budalla zoti im dhe i tregon të shoqes nuk asht faj im.

Njeriu i mirë e dëgjoi debatin e kafshëve dhe vendosi të mos e tregojë sekretin që do ti kushtonte edhe jetën.

-Aman o exhel më le ene nja dy vjet.

-Mirë po të le ene nja dy vjet, po mu nuk më shpëton askush, i thotë exheli.

Në fund të dy vjetëve, bamirësi shkoi larg në një qytet dhe e lyei surratin me zift që të mos e njihnin. Plak, i zi, nuk do meret kush me mu, mendoi njeriu.

Por exheli që e ndiqte me sy në çdo hap atë dhe të gjithë njerziti e takon dhe i thotë: "Or filani, pse je nxi ashtu, nuk të vjen marre. Shko laju e zbardhe faqen e të të marr me faqe të bardhë se unë të marr edhe me faqe të zeze, por më keq për ty.

NË KËTË BOTË KA VEND PËR TË GJITHË

Në këtë botë ka vend për të gjithë. Ka vend për të gjithë kafshët që nga peshku në det e deri tek elefanti, për ariun, për ujkun, dhelprën, lepurin e ketrin. Ka vend për të gjithë bimët që nga bari deri tel pema më e lartë. Ka vend për të gjithë njerziti, të pasur e të varfër.

FJALË TË URTA NGA STEBLEVA DHE DIBRA

1. Mos jep dhe mos merr kurrë pare me fajde.
2. Respektoje Zotin gjithmonë, jo vetëm kur ke nevojë.
3. Vullneti i fortë dhe durimi forcon karakterin.
4. Njeriu pa karakter nuk është njeri.
5. Talenti është pasuri e dhënë nga natyra.
6. Është me të dhënë, nuk është me të thënë.
7. Durimi dhe karakteri i fortë të ndihmojnë për të përballuar gjithçka.
8. Mos plotëso tekat se ato dobësojnë karakterin e fortë.
9. Përballu me fatkeqësinë kur nuk e shmang dot.
10. Toleranca është shprehja më e lartë e trimërisë dhe durimit.
11. Nuk është trim ai që nuk mbron vehten.
12. Lufta me vetvehten është lufta më e vështirë.
13. Fati është bashkëudhëtar i padukshëm me njeriun.
14. Gruan ta përcakton fati.
15. Gëzimin shpirtëror e ka vetëm njeriu i drejtë.
16. Jeziti ka shok jezitin.
17. Gruaja e fut shenjtanin në shishe sepse atij i pëlqen të futet.
18. Ne gjykojmë më lehtë të tjerët se vehten tonë.
19. Pa u vërtetuar fajti nuk quhesh fajtor.
20. Gjyqtari që dënon një të pafajshëm është i vetdënuar.
21. Ai që kërcënon të tjerët është i vetkërcënuar.
22. Mirësjellja nuk kërkon para, por ka vlera të jashtëzakonshme.
23. Gjërat që të kujtojnë dhimbje nuk duhet të kujtohen.
24. Mos i rri gruas me temena dhe hyzmeqarit mos i bëj rixha.
25. Mikun mos e mëso duke e mbajtur me para.
26. Ruaju nga lajkat e grave, vapa e dimrit dhe nga buzëqeshja fallso.
27. Fëmijët shumë i duaj, shkolloi dhe lëru uratë, por jo gjë të huaj.
28. Mos e mba syrin tek gjë e huaj, se do shkosh përvëlur.
29. S'ka si pasuria e fituar me djersën dhe punën tënde.
30. Po hyri harami në derë, shtëpia nuk ka mbarësi asnjëherë.
31. Gjer në tre breza e më shumë të ze harami.
32. Ndjesa e vonuar nuk ka vlerën e kërkuar.
33. Puna të formon karakterin.
34. Siç pastron trupin, pastro edhe karakterin.
35. Varfëria përkul vetëm njerziti e paqëndrueshëm.
36. Karakterin e dobëson interesi.
37. Interesaxhiu përshëndet: Mirëmëngjes, o interes!
38. Njeriu me karakter të dobët i ngjan një peme me trung të hollë.
39. Karakteri i mirë është pasuri për atë që e ka.
40. Besa, bujaria dhe trimëria janë vrytete tradicionale të shqiptarëve.
41. Koha është mësuesi më i mirë për njerinë.
42. Koha dhe durimi janë elementë të fuqisë njerzore.
43. Koha është vlerësuesja më e madhe e historisë.
44. E mira dhe e vërteta vonon por nuk harron të vijë.
45. Ai që bëhet vegël e të ligut është më i lig se ai.
46. Gjuha kockë nuk ka, po kocka thyen.
47. Pyet shtatë a tetë, në fund bëj si di vetë.
48. Të mirën që të kanë bërë shkruaje në mermer.
49. Të mirën që ke bërë vetë shkruaje në rërë.
50. Në do të ndalësh ephsin dhe nepsin, agjëro.
51. Bari i keq rritet pa shumë mund, rritet vetë e mbush livadhet.
52. Pas lotëve sytë shohin më mirë.
53. Mos e nis vitin e ri me borxhe të vjetra.



SI TË STUDIOJMË NË KANADA

Jeni një student i interesuar për të studiuar në Kanada? Vizitoni dhe përdorni vebsitet interaktive që kemi treguar. Këto informacione i gjeni në: Are you international student interested in studying in Canada? Gjeni programet dhe shkollat, koston e arsimimit si dhe kërkesat e tyre për një student të huaj.


Aksesin e informacionit që do t'ju ndihmojë, programet dhe shkollat, mundësim arsimimi on-line dhe vlerësimin e krediteve do ta gjeni duke vizituar:

Are you looking to upgrade your education and skills? osee Programs and schools (Programet dhe shkolla)

On-line and distance learning (Mësimi on-line dhe në distancë)

Language schools (Shkollat e gjuhëve)

Credential assessment services (Shërbimet e vlerësimit të krediteve)



*Festivali i Tulipaneve
ne Ottawa*

130 mijë studentë të huaj studiojnë çdo vit në Kanada

Më shumë se 130 000 studentë vijnë për të studiuar çdo vit në Kanada, si dhe për të mësuar gjuhën angleze ose franceze. Shumë prej tyre sjellin një kulturë të pasur në shkollat tona. Dijet dhe aftësitë tuaja janë të mirëpritura. Provincat janë autoritetet kompetente që rregullojnë arsimimin dhe shkollat në Kanada. Për informacion më të detajuar për jetesën dhe studimin në provincat konkrete, kontaktoni direkt shkollën ku dëshironi të studioni.

Mësoni më shumë rreth:

Study permits (Lejës së studimit)

Èork permits for students (Punës së lejuar për studentët)

Information for educational institutions (Informacione për institucionet e arsimimit)

Programet dhe shkollat

Eksploroni mundësitë që ofron Kanadaja për arsimin. Për informacione më të detajuara vizitoni: Canadian programs and schools dhe gjeni atë që i përshtatet më mirë nevojave tuaja.

Mësimi On-line dhe në distancë

Mund të gjeni shumë emra të shkollave kanadeze që ofrojnë programe arsimimi on-line ose në distancë duke

lundruar në web sitet e mëposhtme:

Canadian Virtual University
Canadian Association of Distance Education

Shkollat e mësimi të gjuhës

Në ëbsitet e mëposhtme do të gjeni emra të ndryshëm që do t'ju ndihmojmë në gjetjen e shkollave të mësimi të gjuhës në Kanada:

LangCanada - study English and French in Canada
Canadian Association of Private Language Schools
Canada Language Council
Association of Canadian Community Colleges

Sistemi i vlerësimit të krediteve

Siç kemi treguar më sipër përpara se të filloni punë, profesionet e kualifikuara në Kanada kërkojnë licensë. Për më shumë informacion vizitoni seksionin: Working in Canada

Për të gjetur më shumë informacion rreth krediteve profesionale dhe akademike për të gjithë Kanadanë, adresa dhe numra telefoni të shoqërive profesionale ose tregtare dhe shërbimit të vlerësimit të krediteve në provinca mund të kërkonin në internet ose fletët e verdha.

Ekzistojnë dy lloj sistemi shkollimi në Kanada ai anglofon dhe ai frankofon.



*Pamje nga Universiteti i
Concordia ne Montreal 4*



Parlamenti i Otaves

*Keshjtjella Frontenak
ne Quebec*



*Muzeu i Qyterimit
kanadez ne Ottawa*



*Pamje
nga
Montreali*

*Shkrimet dhe fotot u morën nga libri "Kanadaja" i autorëve
Kastriot Frashëri dhe Shpëtim Cami*

Adresa : Rruga e Dibrës, prapa Akademisë Ushtarake "Skënderbej". Tel 04/271456, 0692065091

